



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike
Mbledhja nr. 09
Prishtinë, më 30 mars 2010, në orën 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJE TË FINANCAVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Kosara Nikoliq, Arsim Rexhepi, Riza Smaka, Synavere Rysha dhe Gani Koci.

Munguan: Anita Morina - Saraçi dhe Enis Kervan.

Nga Organi Shqyrtues i Prokurimit: Ruzhdi Kurtishaj dhe Hysni Hoxha.

Nga Agjencia Kundër Korrupsionit: Mentor Borovci dhe Bedri Mecini.

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Fatime Qorri - Zyrtare Ligjore, KIPRED (Staf Mbështetës), Artan Venhari dhe Albert Krasniqi, Shpresa Miftari – praktikante, nga NDI - Rinor Beka, nga KDI - Driton Selmanaj dhe nga Zyra e Presidentit - Nexhat Shatri.

Mbledhjen e kryesoi: Haki Shatri - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 09.03. 2010,**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2009,**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2009,**
- 5. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ish-in plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – Hapi takimin me propozimin për rendin e ditës. I njoftoi anëtarët e Komisionit se në pikën të ndryshme duhet të përfshihet edhe formimi i Komisionit vlerësues për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e auditorit gjeneral. Ky komision përbëhet nga pesë anëtarë të Komisionit për mbikëqyrjen e financave publike, kjo në bazë të vendimit të Kryesisë së Kuvendit të Republikë së Kosovës, të datës 16 shkurt 2010. Lidhur me pikën dy dhe tre të rendit të ditës propozoi që anëtarët e Komisionit të përqëndrohen në pjesën që ka të bëjë me mënyrën, racionalitetin dhe efikasitetin e parasë publike.

Gani Koci – Tha se mandati ekskluziv i këtij komisioni është: “*Shqyrtimi i raporteve financiare të audituara dhe raporteve të performancës*”. Asnjëri nga raportet e propozuara në rendin e ditës

nuk janë të audituara dhe si të tilla nuk duhet të jenë objekt i shqyrtimit dhe i trajtimit të këtij komisioni. Si Komision, askush nuk na ndalon që t'i shqyrtojmë dhe në bazën e asaj të kërkojmë që të bëhet auditim i veçantë, në këtë rast për këto dy agjenci. Këto dy agjenci do të përgjigjen edhe në komisione të tjera të Kuvendit, prandaj mos t'i shumëfishojmë punët dhe të merren të gjitha komisionet me të njejtën çështje. Me vizitat që Komisioni ka pasur në Angli, çështja e fushëveprimit të këtij komisioni është sqaruar. Nuk marr pjesë në zhvillimet e këtij komisioni me këto pika të rendit të ditës dhe për raporte të tjera të kësaj natyre periodike që na vijnë, përderisa nuk vendoset dhe nuk votohet në Kuvend mandati i këtij komisioni. *Ne është dashur të kërkojmë atë që kemi kërkuar në takimin e fundit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, që deri më 15 mars do të duhej të na vinte një raport i audituar i RTK - së.* Një raport i tillë nuk ka ardhur dhe interesimi i kryetarit të Komisionit do të duhej të përqëndrohej në këtë, të kërkojë nga zyra përkatëse, sepse 15 marsi ka kaluar. Prandaj, propozoj që ky rend ditë të mos miratohet dhe jo vetëm ky rend dite, por asnjë rend dite që përmban raporte periodike të agjencive.

Riza Smaka – Propozoi që Komisioni unanimisht të kërkojë nga auditori i përgjithshëm të bëjë auditimin e Bankës Qëndrore. Kjo duke ju referuar 550 milionë eurove të tretura, që nuk dihet se ku janë. Po të ishte 1 milion, secili do të duhej të ishte tepër i shqetësuar, i brengosur, kjo është një shumë marramendëse. Këtë auditim ZAP duhet ta bëjë në mënyrë imediate dhe speciale dhe të na dorëzojë Raportin në mënyrë që ne ta trajtojmë këtë çështje. *Propozoi që kjo temë të përfshihet në rendin e ditës për këtë mbledhje.*

Nëse ky komision nuk do të ketë juridiksion që t'i mbikëqyrë financat, atëherë unë nuk do të kisha pranuar të jem anëtar i këtij komisioni, sepse nuk do të kishte kurrfarë kuptimi që një komision që e ka emërtimin “*për mbikëqyrjen e financave*”, nuk do të kishte autorizimin e mbikëqyrjes kompetente të financave. Koci, në parim ka të drejtë, por për hir të autoritetit të këtij kuorumi propozoj që të mbahet kjo seancë, ndërkohë vjen rregullorja dhe sqarohen të gjitha këto çështje.

Arsim Rexhepi - U pajtua në të shumtën e asaj që tha Koci. Ai tha se ende nuk i kemi të qarta përfundimisht deyrimet që i kemi si anëtarë të këtij komisioni. Insistoj dhe i thërras ndërgjegjës së atyre që janë anëtarë edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa edhe në këtë komision, që të përcaktohen për njërin prej tyre. Po vihemi para akteve të kryera, mirëpo për hir të asaj që të pranishëm kemi përfaqësuesit e agjencive, propozoi që të procedohet me këtë rend dite, por herën e ardhshme para se të mbahet një mbledhje e Komisionit, thërras Komisionin bashkë me kryetarin që me udhëheqësin e Kuvendit dhe bashkë me Komisionin për Buxhet dhe Financa të sqarojmë dhe t'i definojmë detyrat që i kemi. Kam pritur që sot në rend dite ta kemi çështjen e RTK - së. Ne kemi përcaktuar një ditë të fundit që ata është dashur të sjellin një raport dhe nuk e kanë sjellë. Kjo po vazhdon që disa vite me këtë institucion, të cilin financiarisht po e mbështesim, andaj propozoj që në një mbledhje, sa ma shpejt, kjo çështje dhe çështjet për të cilat diskutuam më lart të jenë pikë e rendit të ditës.

Safete Hadergjonaj - Tha se duhet të bëjmë përpjekje maksimale ta ruajmë dinjitetin e këtij komisioni, por nëse veprimet kështu, ne nuk do ta bëjmë këtë, sepse me këto raporte që nuk janë objekt trajtimi për këtë komision, do të japim një mundësi që të flasim me hamendje, diskutojmë me hamendje, flasim me paragjykime dhe në mungesë të fakteve që janë të domosdoshme për këtë komision. Një diskutim të tillë me hamendje dhe me mungesë faktesh e kemi bërë edhe te Raporti i KRPP - së, sepse me këtë kontatohet një gjendje e këtij komisioni. Mirëpo nuk kemi bazë për të diskutuar ose debatuar në funksion të këtij komisioni, për arsye se ne kemi të bëjmë me mbikëqyrjen e financave publike. Jam kundër këtij rendi të ditës dhe pajtohem me propozimet që bënë Koci dhe Rexhepi për RTK - në. Ka qenë edhe përfundim i Kuvendit që raportin të vijë drejtpërdrejt deri me 15 mars. Pajtohem edhe me çështjen që e ngriti Smaka lidhur me kontrollin e mjeteve që kanë të bëjnë me privatizimin e Bankës Qëndrore të Kosovës, d.m.th. ne duhet të insistojmë që përmes auditorit të përgjithshëm t'i kemi këto raporte dhe pastaj të diskutojmë, por edhe nëse kemi shqetësime me raportin e KRPP-së, OSHP-së apo me raportin e AAK-së, ne duhet të kërkojmë nga auditori që ai të bëjë një auditim dhe pastaj të vijmë te

konstatimet reale se si po shfrytëzohen mjetet aty apo çka ka konstatuar auditori? Nëse shkojmë në këtë mënyrë ne në fakt nuk e kemi kryer funksionin e këtij komisioni.

Synavere Rysha – Lidhur me rendin e ditës tha se ka dilema. Pjesërisht u pajtua me diskutimin e deputetit Koci. Ajo tha se jemi pajtuar që të merremi kryesisht me raporte të audituara, duke i përjashtuar raportet që vijnë vetëm si raporte. Por nuk u pajtua me deputeten Hadergjonaj kur thotë se me hamendje flasim. Si mund të flasim me hamendje me një raport që ka autorësi, që e kanë përgatitur persona kompetent për të bërë një punë të tillë? Raporti i KRPP- së që u shqyrtua në mbledhjen e fundit, ka qenë një raport jashtëzakonisht i mirë, mjaft mirë i detajuar, i sqaruar, dhe e ka pasqyruar gjendjen reale. Auditimi vetëm se na kompletton çështjen dhe thjesht na jep udhëzimin se kah mund të ecim ne. Askush në atë mbledhje nuk ka folur me hamendje, por e ka thënë atë që ka menduar dhe atë që qëndron në bazë të raportit. Nëse vërtet ka hamendje, ne do të detyrohemi që të kërkojmë sqarime. Duke pasur parasysh që rregullorja nuk është finalizuar dhe Komisioni për mandate dhe imunitete nuk e ka dhënë mendimin lidhur me mandatin e këtij komisioni, propozoi që mbledhja e Komisionit të vazhdojë me këtë rend dite.

Safete Hadergjonaj – Nëse i referohemi procesverbalit të mbledhjes së kaluar, në të cilën mbledhje kam marrë pjesë personalisht, kam përgëzuar përfaqësuesin e KRPP - së, i cili ju është përgjigjur hamendjeve tona ose paragjykimeve tona që i kemi pasur për disa çështje, por mungesa e fakteve që kanë të bëjnë ekskluzivisht me Komisionin tonë, na bëri që atë ditë disa të flasim me hamendje ose paragjykime dhe nga ato paragjykime tona të kërkojmë përgjigje nga përfaqësuesit e KRPP - së. Ky është fakt, është realitet.

Synavere Rysha – Tha se nuk mund ta quaj hamendje kur flasim për një çështje që ne e debatojmë. Ne si pjesë e politikës, asnjëherë nuk do ta kemi faktin, mirëpo do ta kemi argumentin që shkruan. Atë fakt do ta ketë vetëm auditori, ndërsa ne do të debatojmë me raporte.

Kosara Nikolic – U pajtua me kolegët e saj, deputetët Koci dhe Hadergjonaj, rreth pikës tre dhe katër të rendit të ditës. Ajo tha se do të ishte e kotë që Komisioni t'i shqyrtojë raportet të cilat do t'i shqyrtojë edhe Komisioni për buxhet. Ne nuk mund të japim kontributin tonë, sepse nuk kemi argumente reale, prandaj kërkoj që sa më shpejt të miratohet rregullorja e punës dhe pastaj të kemi një mbledhje me Kryesinë e Kuvendit që ky komision të funksionojë dhe të punojë për ato çështje për të cilat është formuar, sepse shumë gjëra kemi mësuar nga vizita në Angli.

Gani Koci – Tha se Rregullorja e punës së Kuvendit lejon që një deputet të jetë në një ose më shumë komisione dhe këtu nuk ka konflikt interesi. Në dy vende evropiane ka komisione të veçanta për mbikëqyrjen e financave publike, por në të gjitha vendet e tjera ky komision është nënkomision i Komisionit për buxhet dhe financa. Si i tillë ky nënkomision ka një raportues që i raporton KBF - it, i cili pastaj i raporton Kuvendit. Nëse nisemi nga këto praktika të shteteve, atëherë këtu nuk ka konflikt interesi, ata nuk janë më pak të mençur se ne. Çështja duhet të definohet qartë: *nuk është në kompetencë të këtij komisioni që të shqyrtohen raporte periodike të agjencive buxhetore. Kjo nuk është askund në botë dhe s' duhet të jetë as te ne.* Kur e kemi raportin e audituar, vijmë deri te gjetjet, diskutojmë për to dhe nëse nuk pajtohemi me ato çështje, prapë kërkojmë auditim. *P.sh.: "OSHP thotë se ka pasur 50 ankesa, 6 kanë pasur këtë vlerë, lidhur me to është vendosur kështu", nga kjo ne kemi marrë një informacion se e kanë kryer një punë, por si është kryer ajo punë? Ajo që quhet performancë nga ky raport ne nuk e marrim. Si anëtar i këtij komisioni, nuk marr pjesë në mbledhje, nëse punojmë me këtë rend dite ose me raporte që nuk janë të audituara ose të performancës.*

Deputetët Gani Koci dhe Safete Hadërgjonaj e lëshuan mbledhjen.

Kryesuesi – Tha se pjesa që ka të bëjë me Raportin e buxhetit dhe të shpenzimeve buxhetore nuk do të jetë sot pjesë e shqyrtimit. Nuk e vlerësojmë se OSHP- ja ka punuar mirë ose jo, kanë shpenzuar buxhetin në bazë të ligjit ose jo, sot nuk e bëjmë, por pasi të bëhet auditimi nga Auditori i Përgjithshëm i të gjitha organizatave buxhetore. Si deputetë, si strukturë e Kuvendit

është të shohim se te organizatat buxhetore, te procesi i prokurimit, ku ka pasur shkelje, si reagohet në vendimet, a respektohen ato, a kanë marrë masa strukturat të caktuara kur kanë marrë vërejtje? Këto janë interesimet tona si KMFP. Në përgjithësi ne na intereson mënyra e shpenzimit të parasë publike. Sipas Rregullores në fuqi, që është miratuar në Kuvend, kur është miratuar formimi i këtij komisioni, kemi shumë më shumë kompetenca dhe ajo është ende në fuqi. Lus anëtarët e Komisionit që shkurtimisht të kalojmë nëpër çështjet e propozuara për këtë mbledhje. Nuk dua që të bëj politikë, mundem të flas në mendia, si kryetar Komisioni, por dua që paraprakisht të marrë mendimet e autorizuara, nga strukturat që janë ligjore.

Arsim Rexhepi – Tha se ju kam bërë ftesë juve që të jepni një shembull, që të jepni dorëheqje nga Komisioni, ku jeni anëtarë, në një mënyrë ose në një tjetër ky është konflikt interesi dhe ju vazhdoni të jeni pjesë e kësaj, kryetar dhe si pasojë e kësaj ne kurrë nuk do të jemi produktiv në këtë komision.

Unë nuk jam i gatshëm të marr pjesë në mbledhje të tilla, ku vazhdimisht jam i terrorizuar të jemë viktim konflikteve të interesit. Për hir të asaj që ne i kemi të pranishëm njerëzit që ju keni ftuar në mbledhje, propozova që të futet në rend dite edhe një pikë, unë nuk do ta bojkotoj këtë mbledhje dhe do ta votoj këtë rend dite. Mirëpo, nuk janë të pabaza ato që thanë dy kolegët që e lëshuan mbledhjen.

Kryesuesi – I kujtoi anëtarët e Komisionit se, KMFP në një nga mbledhjet e kaluara, ka nxjerrë një rekomandim, i cili është përcjellë në Kryesinë e Kuvendit, sipas të cilit KMFP të qenurit anëtarë në KBF dhe në KMFP e konsideron se është konflikt interesi.

Ai u pajtua me dy propozimet, që në rend ditë të përfshihen për diskutim Raporti i audituar i RTK - së, si dhe kërkesa e Smakës që të kërkohet nga ZAP auditimi i Bankës Qëndrore dhe formimi i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e auditorit për auditimin e auditorit të përgjithshëm.

Synavere Rysha - Raportet e parpara për këtë rend dite janë raporte të paaudituar, mirëpo në mandatin e këtij komisioni janë edhe shqyrtimi i këtyre raporteve. Jemi shumë të vetëdijshëm me mënyrën se si duhet të punojmë në të ardhmen, por ne duhet të presim edhe një vit që të kemi raporte të performancës, të na vijnë në kuvend dhe pastaj të merremi me to. Duke e pasur këtë vakum, ne si Komision detyrohemi të punojmë për aq sa të jetë efikase dhe efektive puna jonë. Propozoj që të vazhdojmë me këtë rend dite, duke i reduktuar situatat.

Pas diskutimeve të deputetëve kryesuesi konstatoi se të pranishëm në mbledhje janë 5 anëtarë të Komisionit.

Komisioni për mbikëqyrjen e financave publike me 4 vota për dhe një abstenim e miratoi rendin e ditës të propozuar për këtë mbledhje, duke përfshirë këtu edhe propozimet e anëtarëve të Komisionit, që në rend dite për diskutim të përfshihen: kërkesa për auditimin e Bankës Qendrore dhe raporti i audituar i RTK - së i cili është dashur të procedohet në kuvend deri më 15 mars.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 09 mars 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 09 mars 2010.

3. Shqyrtimi i Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2009

Kryesuesi – Tha se Raporti i OSHP- së, është raport i rregullt vjetor, që i paraqitet Kuvendit dhe çdo deputet, çdo Komision ka të drejtë ta diskutojë dhe ta shqyrtojë. Raporti është i plotë, pasqyron gjithë veprimtarinë e Organit Shqyrtues dhe pasqyron edhe rastet që në procesin e prokurimit të të gjitha organizatave buxhetore nuk kanë shkuar sipas rregullave, për të cilat Organi Shqyrtues është i obliguar që t'i shqyrtojë ato ankesa, rekomandime etj. Hap diskutimin.

Përfaqësuesi i OSHP- së, Ruzhdi Kurtishaj - OSHP - ja nuk ka të drejtë të hulumtojë në menaxhimin e parasë publike në autoritetet kontraktuese. Raste ku Organi Shqyrtues ka shqyrtuar urdhëresat nga autoritetet kontraktuese për mosrespektimin e vendimit të panelit shqyrtues janë: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Forcës së Sigurisë, Ministria e Administratës Publike, KK Prishtinë, KK Gjilan, KK Ferizaj dhe KK Rahovec (f. 25 e raportit). Prej të gjitha këtyre, të gjeturave që ka bërë OSHP- ja lidhur me mospërbushjet e obligimeve ligjore, ndaj nenit 117, Ligjit të prokurimit publik, kanë marrë një sanksion dhe ka intervenuar në KK të Rahovecit, ku kanë shqiptuar një denim me gjobë në vlerë prej 5000 euro, dhe e ka larguar nga puna menaxherin e këtij prokurimi. Ndërsa te autoritetet e tjera kontraktuese, pasi ka bërë urdhëresën për zbatimin rigoroz të vendimeve të OSHP- së, ato më pastaj kanë bërë zbatimin e këtij vendimi dhe nuk kanë shkuar deri në shkeljen e plotë të ligjshmërisë. Kur kemi të bëjmë me marrjen e vendimeve të OSHP për kthimin e lëndëve në rivlerësim, atëherë një kategori e caktuar e autoriteteve kontraktuese tentojnë t'i ikin zbatimit të këtij vendimi dhe menjëherë në afat të caktuar ligjor prej 15 ditësh, ndonjëherë edhe jashtë këtij afati, njoftojnë se kanë anuluar aktivitetin e tillë të prokurimit, kur në fakt sipas dispozitave të caktuara të Ligjit të prokurimit, ato duhet ta zbatojnë vendimin e OSHP - së dhe duhet të kthejnë lëndën në rivlerësim, konkretisht kemi të bëjmë kur ato nuk i përmbahen kriteriumeve të veta që i paraqesin në dosjet e tyre. Ndërsa kur kemi të bëjmë me shkelje të procedurave, atëherë lënda kthehet në anulim total. Kjo është ajo që është vërejtur nga ana jonë, dhe ajo që do të shtoja është kjo se sipas një rregullore të Ministrisë së Financave, Udhëzim Administrativ, por edhe sipas një rregulloreje të KRPP - së, u është lejuar autoriteteve kontraktuese që ato të mos bëjnë zotimin e mjeteve financiare deri sa të lidhet kontrata me operatorin ekonomik, ndërsa përpara me Ligjin e prokurimit publik, sidomos me ligjin e pandryshuar e vitit 2003, asnjë autoritet kontraktues nuk ka mund të hapë procedura, implementimin e një projekti, pa i pasur të zotuara mjetet financiare. Dhe tash këto dy udhëzime ju bëjnë të mundshme që t'i hapin të gjitha procedurat e tenderit pa pasur mjete të zotuara dhe në momentin kur autoriteti kontraktues nuk i konvenon realizimi i një projekti, rast konkret kur ne prishim një vendim të atyre dhe e kthejmë në rivlerësim, ai automatikisht e anulon atë, e pastaj ai thirret në atë se nuk kam mjete. Mirëpo, më parë ka qenë një garancion më i fuqishëm, sepse ato mjete janë ndarë dhe do të duhej të shfrytëzohen vetëm për atë dedikim. Unë mendoj që menaxhimi i mjeteve publike tani është në kundërshtim me interesin e përgjithshëm, me vetë vlerën e shfrytësimit të mjeteve publike.

Arsim Rexhepi – Pyeti: Pse ndodhë kështu, dhe kur është nxjerrë ky Udhëzim Administrativ? Ministër në atë kohë ka qenë Haki Shatri.

Përfaqësuesi i OSHP- së – Tha se nuk e di, kush dhe si e ka arsyetuar nxjerrjen e një Udhëzimi Administrativ për lejimin e implementimit deri në fazën përfundimtare të një projekti pa pasur zotimin e mjeteve. Ky **Udhëzim Administrativ** është nxjerrë diku para tre vjetëve. Është edhe **Rregullorja B** e KRPP - së. Ne kemi konstatuar raste kur kontratat janë nënshkruar në mungesë të mjeteve financiare dhe pastaj nuk kanë ardhur deri te implementimi i atij projekti, të realizimit të kontratës dhe kjo me arsyetimin e thjeshtë: “*nuk kemi para*”. Ata pastaj bëjnë ankesë në OSHP, në fakt ata duhet t'i drejtohen gjykatës për këtë çështje, sepse te ne me t'u nënshkruar kontrata në mes të autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik është e përfunduar, por ata drejtohen te ne, e në të vetmen mundësi e kemi të nxjerrim edhe një urdhëresë, që të shfrytëzojmë maksimumin nga autoriteti kontraktues. Këto janë ato defektet që ligji i ka paraparë, **moszotimin e mjeteve**.

Kryesuesi – Pyeti: atëherë kur ka pasur nënshkrim kontrate dhe nuk ka pasur mjete të realizohet kontrata, ai projekt a ka qenë edhe me kod buxhetor?

Përfaqësuesi i OSHP - së – Ai projekt ka qenë në buxhet. Ka shumë autoritete kontraktuese që realizojnë projekte dhe nuk kanë kode. Pritet të na dorëzohet një Draftligj i prokurimit publik, dhe në afatin e caktuar do të procedohet në komisionet tuaja nga Qeveria.

Synavere Rysha – Shpreh interesim për situatën kur fillojnë procedurat e prokurimit dhe mjetet nuk zotohen. Ligji mbi prokurimin thotë: “*Fillimisht të zotohen mjetet e pastaj të vazhdojnë*

procedurat”. Sipas përfaqësuesve të OSHP- së kjo bëhet ndryshe. Ministria përkatëse ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ dhe KRPP - ja ka nxjerrë Rregullore për ta rregulluar këtë çështje, mirëpo, kjo është treguar e dëmshme. Prandaj kërkoi sqarim, çka përmban Udhëzimi Administrativ dhe Rregullorja e KRPP – së, si i parasheh?

Përfaqësuesi i OSHP - së – Rregullorja e KRPP- së i referohet Udhëzimit Administrativ dhe kjo është bërë në funksion të shpejtimit të realizimit të projekteve.

Riza Smaka – Tha se me Rregullore, me udhëzim nuk mund të ndryshohet ligji. Kjo është puna më e paligjshme, është abuzim. Nuk aludoj në individ, por në institucion. Rregullorja duhet të jetë vetëm precizim i dispozitave ligjore. Parim esencial në kontrata është që autoriteti kontraktor t’i ketë mjetet e zotuar 100%, dhe pastaj në realizimin e projektit, d.m.th. ky është parimi elementar fundamental në kontrata, *Pacta Sunt Servanta*, sepse këtu s’ka diskutim, ato veprime janë abuzive dhe korruptive. Ky komision është më kompetenti që ta mbikëqyrë financën publike, buxheti është dokument që miratohet me ligj, pastaj vijnë 3 E famshme: Efektiviteti, Eficienca dhe Ekonomiciteti. Kontrakton një autoritet pa pasur mbulesë, ajo është shkelje flagrante e kontratës dhe nuk do të mund të kalonte pa u ndëshkuar. Pyeti: cilat janë sanksionet kur ju konstatooni se është kontraktuar në kolizion me ligjin? E ktheni për rikontraktim, atëherë kur ju urdhëroni për ta rivendosur çështjen, e më pastaj u anulua! S’mund të anulohet! Duhet të përfillen udhëzimet e tuaja, por cilat janë ato?

Arsim Rexhepi – Ju e përmendet se ka raste kur objektet kontraktive janë në buxhet dhe nuk kanë kod, si është e mundur kjo dhe çfarë bëni ju pasi që ta shihni se ka ndodhur diçka e tillë? A ka bazë ligjore, nëse po, ku e ka këtë bazë?

Përfaqësuesi i OSHP - së – Sipas nenit 117 të Ligjit për prokurim publik, në rast se një autoritet kontraktues përpiket t’i bishtërojë zbatimit të këtij vendimi të organit më të lartë të prokurimit, siç është OSHP - ja, atëherë OSHP ka të drejtë që përmes një urdhërese para së gjithash të paralajmërojë autoritetin kontraktues për sanksionet që mund të miratohen. Në rast që edhe pas asaj urdhërese autoriteti kontraktues vazhdon me të veten, atëherë OSHP- ja ka të drejtë që autoritetit kontraktues t’ia shqiptojë një dënim më gjorbë, por jo më shumë se 5000 euro dhe të marrë masa ndaj menaxherit të atij autoriteti kontraktues, duke ia marrë licencën atij për 3 vjet, duke e larguar tërësisht nga puna dhe duke ia shqiptuar një gjorbë, më së shumti 1000 euro. Kjo është e paraparë me ligj. Ne e kemi pasur krejt një rast të tillë këto dy vjet, të tjerët i kanë zbatuar urdhëresat tona.

Ndërsa, sa i përket asaj për mungesën e kodit financiar, nuk është kompetencë e jona për t’i kontrolluar ato, por në bazë të praktikave, që për realizimin e një projekti ka pasur kod zgjedhor dhe nuk është zbatuar ajo, sepse pastaj me korigjimin e buxhetit që bëhet në 6 mujorin e dytë, atëherë e kanë ndërruar atë kod buxhetor për realizimin e atij projekti, d.m.th. e kanë çuar dikah tjetër, kështu që ata arsyetohen se ka pasur kod buxhetor, por e kemi transferuar. Dhe kemi hasur gjithashtu që edhe pa kod financiar dhe pastaj kanë bërë realizime. Nuk do të përmendi ndonjë ministri të caktuar, sepse nuk jam kompetent për atë punë, por po që se një auditor i mirëfilltë mund t’i konstatojë këto të gjetura.

Kryesuesi – Nuk është në kompetencë të Organit Shqyrtues obligimi që një projekt të ketë kod ose jo. Është obligim i Ministrisë së Financave që kur të propozojë Projektbuxhetin për vitin që vjen çdo projekt investiv ta ketë kodin e vet. Vitin e kaluar kemi pasur raste, unë kam reaguar, ku një ministri përkatëse i ka pasur përmbi 15 projekte pa kod. Unë kam reaguar në Kuvend, sepse kjo nuk është në rregull, ngase pastaj emrat e një projekti mund të ndërrohen kur nuk e ka kodin. Në KBF, nëse ka një dinjitet të vendosjes dhe lirohet dikush nga ndikimi politik i rastit ose i grupit që graviton, duhet të kërkohet me këmbngulësi që nuk është kundër dikujt, por është në favor të zbatimit të ligjit. Sepse kur të votohet buxheti, çdo projekt investiv ta ketë kodin e vet, i zvoglon mundësitë për makinacione të mëvonshme në interesa të dikujt.

Arsim Rexhepi – Pyeti kryesuesin e Komisionit: çfarë interesi keni pasur për të dhënë një Udhëzim Administrativ që ka qenë jologjor, jo i drejtë? Pse e keni dhënë? Sa kam unë të drejtë morale që të rri në një komision, që e udhëheq një njeri që ka lëshuar udhëzime, që e kanë dëmtuar këtë vend. Nëse ke bërë ashtu, unë nuk jam më anëtar i këtij komisioni.

Kryesuesi - Ne nuk e dimë se për cilin vendim është fjala. Kur të kuptojmë saktë se për cilin udhëzim është fjala, atëherë mund të bisedojmë dhe ju duhet të më kërkonti falje publike. Dua të jem korrekt dhe nëse del që është nënshkruar në kohën time, unë do të përpiqem që të përmirësohem, por nuk e besoj një gjë të tillë. Unë e di që kam qenë shumë rigoroz. Nuk mund të nënshkruhet një kontratë me ndonjë operator pa qenë mjetet e zotuara. Kjo ka qenë rregull.

Arsim Rexhepi - Tha se nëse e vërtetojmë se një udhëzim i tillë administrativ është lëshuar nga ju, kryetar, gjatë kohës kur ju keni qenë ministër, ju do të jepni dorëheqje, nëse është e kundërta unë do t'ju kërkoj falje. Nuk mund të rri, të më udhëheq një njeri që ka bërë vendime të padrejta për shtetin tim, për fëmijët e mi, për ardhmërinë time. (*E lëshoi mbledhjen*).

Kryesuesi i njoftoi anëtarët e Komisionit, meqenëse edhe deputeti Arsim Rexhepi e lëshoi mbledhjen, Komisioni nuk ka kuorum për të vendosur lidhur me çështjet, por do të vazhdojmë me diktimit për të dëgjuar palët e ftuara për këtë mbledhje.

Kryesuesi – Konstatoi se për KMFP, Raporti OSHP - së është i pranueshëm. Ai tha se punën e organit shqyrtues e vlerësojmë pozitivisht dhe krejt çka ka të bëjë me mënyrën e shfrytëzimit të parasë publike, do të kërkojmë shpjegime, do të kërkojmë interpretime profesionale. Numri i madh i ankesave në njërin anë thotë rritje e besimit në OSHP, por në anën tjetër, a do të thotë që strukturat që e shfrytëzojnë paratë publike të agjencive shpenzuese diçka nuk po ecën mirë. Rastet që janë ekcesive, që ju i konstatoni, ose në bazë të ankesave ose në bazë të punës tuaj që bëni, a bashkëpunoni edhe me AKK - në dhe me prokurori, si reagohet në këto raste?

Përfaqësuesi i OSHP- së – Kemi bashkëpunim të shkëlqyeshëm me AAK- në, gjithashtu kemi bashkëpunim edhe me prokurorinë publike, ndonse nuk kemi pasur ndonjë rast prej prokurive publike që na është drejtuar neve për ndonjë ndihmë. Nga AKK- ja kemi pasur shumë kërkesa dhe jua kemi përcjellë shumë prova, gjitha materialet që i kanë kërkuar ata, ne ua kemi përcjellë.

Kryesuesi – Do të thotë ju e keni një vlerësim, që nuk është reagimi aq adekuat i prokurisë dhe i gjyqësisë në relacion më atë që ju e konsideroni të nevojshme?

Përfaqësuesi i OSHP-së – Nuk kemi kemi pasur kërkesa nga prokuroria, ndërsa nga AKK- ja kemi pasur dhe kemi bashkëpunim të shkëlqyer.

Kosara Nikolic – Vazhdimi i kësaj mbledhje më nuk ka kuptim. Mbledhja duhet të përfundoj, sepse më nuk kemi kuorum. Duhet të caktohet mbledhje me Kryesinë, të miratohet rregullorja, në mënyrë që të mos e akuzojmë njëri - tjetrin, por të punojmë rreth detyrave tona. (*E lëshoi mbledhjen*).

Kryesuesi – Në mungesë të kuorumit ne nuk do të marrim asnjë vendim. Por ju kujtoj se në rend dite e kemi edhe formimin e Komisionit vlerësues prej 5 anëtarëve të këtij komisioni, në bazë të vendimit të Kryesisë, për të vlerësuar ofertat për auditorin që do të auditojë, auditorin gjeneral. Nëse kjo nuk ndodh atëherë, ne me paramendim nuk po bëjmë një gjë të tillë. Dikush me paramendim e ka refuzuar herën e parë një propozim të auditorit gjeneral, me tre oferta të përgjegjshme edhe sot po e zgjatë formimin e komisionit në bazë të procedurës së re të filluar nga Kuvendi. Në raportin që do të bëjë Komisioni Evropian, mos përcaktimi i auditorit për auditimin e auditorit gjeneral do të jetë një minus për Kosovën. Personalisht do të deklarojmë publikisht se kush po ndikon që të mos ketë korum, që të merret një vendim lidhur me auditimin e auditorit gjeneral, kush propozon, por nuk dëshiron të jetë këtu kur të merret vendimi për t'i kërkuar auditorit gjeneral auditimin e Bankës Qëndrore lidhur me shkeljet që janë bërë ose me

dilemat e shfrytëzimit të fondit të mirëbesimit. Kush propozon këtu dhe del jashtë kur duhet të vendoset për temat që kanë të bëjnë me fatin e parasë publike, me fondin e mirëbesimit. Kush propozon dhe del jashtë kur duhet me u përshpejtuar Raporti i auditimit të RTK- së, dhe për të gjitha këto, si kryetar i Komisionit, do të deklarohem para mendiave dhe ju autorizoj që të gjithë ta thoni fjalën tuaj. *Kërkojë nga sekretaria që gjithmonë në punën KMFP- së të njoftohen mediat.*

Riza Smaka – Secili ka të drejtë të japë pikëpamjen ose mendimin e vet në mbledhjen e Komisionit, por nuk është korrekte, nuk është aspak në frymën e funksionit të një anëtari të Komisionit që ta lëshojë mbledhjen, e gjykoj këtë. Kërkoj nga kryetari i Komisionit që ta bëjë atë që duhet bërë në mënyrë që rregullorja të miratohet sa më shpejt, sepse në qoftë se nuk inkorporohet kompetenca e mbikëqyrjes financiare e këtij komisioni, atëherë duhet të mendojmë, a duhet të ekzistoj ky komision apo jo? Dikush dëshiron që mos ta kemi një Komision të tillë, ose ta kemi, por vetëm të formatizuar, pa efekte. Duhet ta gjejmë një formë efektive për të reaguar.

Synavere Rysha – Tha se në një Komision kaq të rëndësishëm dhe kaq vendimmarrës, që i elaboron mirë situatat, të mos jenë deputetët e pozitës këtu, pikërisht është ajo frika dhe dëshira për të mos i zbardhur asnjëherë rastet. Fjala “*0 korrupsion*” sikur po e flet një fjalë tjetër. Do ta them me përgjegjësi dhe nëse është nevoja edhe para mediave, sepse pozita është ajo të cilës nuk po i pëlqen puna e Komisionit, nuk është e interesuar situatat t’i çojë deri në fund dhe raportet t’i vlerësojë në mënyrën më të mirë të mundshme.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2009

Kryesuesi – Propozoi që të dëgjohej edhe përfaqësuesit e AKK- së, pavarësisht asaj që Komisioni nuk ka kuorum për të marrë një vendim.

Synavere Rysha – Ne bëjmë kontroll, por mbi raportet e audituara, jo mbi raportet e tjera, kështu kemi biseduar dhe jemi dakorduar në një farë mënyre. Raportet që i kemi në rend dite edhe pse thonë mjaft, nuk janë objekt trajtimi i Komisionit tonë. Mirëpo, në situatën konkrete nuk është keq të fillojmë me këto raporte deri sa të procedohen raportet e audituara.

Auditori duhet të jetë ai që vërteton dhe në bazë të raporteve të auditorit duhet të veprojë edhe AKK -ja. Në njëfarë mënyre, puna e tyre është e ndërlidhur, mirëpo AKK- ja gjithmonë ju referohet raporteve të auditorit dhe informatave që marrin nga të tjerët, nëse ka dyshime ata e hulumtojnë rastin. Ne, si Komision, jemi ekskluzivisht të lidhur në atë që është mirë e vërtetuar dhe mirë e përfunduar. Besimi i qytetarëve ndaj AKK- së është dhe kjo duket, perderisa ata raportojnë. Çfarë ka ndodhur me bashkëpunimin me institucionet dhe zyrtarët e lartë? Si është ky nivel? Cili është niveli i bashkëpunimit dhe sa janë të gatshëm të kontribuojnë ata në këtë drejtim?

Përfaqësuesi i AKK- së – Agjencia Kundër Korrupsionit e Kosovës është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Kosovës. Ne mbikëqyrimi dhe i raportojmë Kuvendit të Kosovës, pavarësisht se si vendos Kuvendi, se cilit Komision t’i raportojmë. Ne e kemi këtë gadishmëri, meqenëse jemi organ që mbikëqyrimi nga Kuvendi i Kosovës. Risi në këtë vit është se kemi pranuar 35% më shumë informata, në raport me vitin e kaluar. Kjo tregon se qytetarët tanë po sensibilizohen dhe po kanë më tepër guxim që t’i raportojnë rastet e korrupsionit. Çka është me rëndësi të përmendet është se këtë vit Agjencia gjithashtu ka shtuar edhe numrin e rasteve të trajtuara në raport me vitin e kaluar, nga 175 informata të pranuar, 68 informata janë përcjellë në prokurori, 103 janë mbyllur në mungesë të provave, në mungesë të kompetencës, ose për shkak se procedura vetëm se ka filluar në prokurori me qëllim që të mos zhvillohen dy procedura paralele; 26 raste janë në procedurë. Ky raport i referohet datës 31 dhejtor, dhe kemi lëvizje edhe gjatë këtyre muajve të vitit 2010. Natyra e shkeljeve është e ndryshme, i kemi pranuar 34 informata anonime prej tyre 17 janë përcjellë në prokurori. Kemi bashkëpunim shumë të mirë edhe me prokurorinë e EULEX- it dhe me Policinë e Kosovës. Në EULEX kemi përcjellë 34 informata, ka pasur 5 aktakuza të ngritura, në 5 raste ka pasur arrestime, rastet tjera janë duke u

hetuar, e disa raste janë mbyllur. Deklarimi i pasurisë ka shkuar në mënyrë të rregullt, 16 zyrtarë që nuk e kanë deklaruar pasurinë, është kërkuar zvoglimi i pagës për 20%, 6 kërkesa për shkarkim, në fazën e fundit 100% e zyrëtarëve kanë bërë deklarin e pasurisë. Kemi një lëvizje pozitive, në kuptimin e kompletimit të legjislacionit, janë nxjerrë 3 ligje antikorrupsion: Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit, që veç ka hyrë në fuqi, për parandalimin e konfliktit të interesit me amendamentim të ligjit deriatëhershëm dhe Ligji për deklarin, prejardhjen kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtarëve të lartë publikë. Konflikti i interesit – 47 informata, në 6 raste janë shmangur, 27 raste janë mbyllur, janë shuar 5 opinione. Kemi pasur bashkëpunim të mirë edhe me institucionet e tjera, me një pjesë prej tyre veçse kemi memorandume bashkëpunimi, siç është me prokurorinë e EULEX-it, me Ombudspersonin, me Komisionin e Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, kemi në plan që të arrijmë memorandume edhe me institucionet e tjera, në radhë të parë me prokurinë e shtetit, policinë, administratën tatimore, KRPP etj. Në fushën e edukimit, vlen të përmendet se kemi qenë nikoqirë të një vizite zyrtare të një institucioni të ngjajshëm nga Republika e Shqipërisë dhe kemi organizuar bashkëpunim me UNDP -në, një konferencë regjionale e cila ka qenë e para e këtij lloji në Kosovë, ku është diskutuar për çështjet e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit. Buxheti është shpenzuar në masën 79.44% .

Kryesuesi – Fushë e interesimit tonë nuk është buxheti. Prej faqes 11 e tutje të Raportit, shihet se shtimi i rasteve të paraqitura dhe shtimi i rasteve që janë proceduar, është rritur në krahasim me një vit më herët, që na sinjalizon, ne, si Kuvend dhe këtë komision, si organ kompetent që të alarmohemi dhe të ndërmarrim diçka. Fatkeqësisht kjo ndodh në organet qeveritare, siç shkruan, sigurisht te ndonjë ministri është fjala, ndodh edhe te ndërmarrjet publike, d.m.th. ju e monitoroni edhe shpenzimin e parasë publike edhe atje. Kjo na bënë që ne të diskutojmë këtë. Unë kam parë këto, edhe ne faqen 13 janë në veçanti, dhe janë mjaft shqetësuese, kur thojnë se rastet më të shpeshta të shkeljeve janë te procedura e prokurimit, sepse fusha e prokurimit është fusha ku potencialisht bëhet shkelja e rregullave të shpenzimit të parasë publike.

Nga raporti shihet qartë që dukuria e korrupsionit nuk është zvogëluar, por është në rritje. Dhe nga faqja 32 e tutje mund të nxjerrim konstatimin se nuk ekziston vullnet për luftimin e kësaj dukurie. Konkretisht thuhet se ju është dhënë rekomandim zyrës së kryeministrit për një person - këtu i shkruan emri - është emri i vetëm që shkruhet në raport- dhe personi pas gjithë atyre vërejtjeve që ju kanë bërë, d.m.th. procedurave që i ka udhëhequr agjencia, krejt çka ka ndërmarrë, prapë vazhdon të punojë dhe nuk i mungon asgjë. Poashtu në të njëjtën faqe shkruan që edhe pas vërejtjeve dhe reagimeve të agjencisë për funksione të dyfishta etj. Personat e rëndësishëm në institucionet tona, vazhdojnë të kryejnë ato punë pa i penguar askush. Edhe raste të tjera, që për mua është indikative se si konstatim nuk ekziston vullneti për t'i luftuar këto dukuri negative, do të ishte mirë që përfaqësuesit e AKK- së të na thonë ndonjë rast konkret kur dikush ka treguar vullnet të mirë dhe do ta lavdërojmë atë strukturë, cilado qoftë ajo.

Riza Smaka – Tha se ky është problem shumë serioz i shoqërisë kosovare. Sot për këtë flitet kudo: në kafiteri, rrugë, holl, amfiteatër, sallë etj. Kjo pikë është shumë e vështirë, por nuk është e paarrtshme, meqë tani e kemi Ligjin për prokurorimin, ndoshta ju që do të kishit eksperiencë për të dhënë kontributë të dukshëm për të propozuar zgjidhjen në ligj, që përveq të tjerave ju duhet të keni autorizime më të mëdha, ju duhet të jeni organ edhe i karakterit politik, sepse ne i dimë shumë raste, prokuroria ose gjykata nuk funksionon, nuk reagon fare, etj.

Përfaqësues i AKK- së –Në mes Agjencisë dhe Prokurisë është vendosur një bashkëpunim tash së fundi, me kryeprokurorin e shtetit ku është themeluar një grup punues, është mbajtur në javën e kaluar takimi i parë dhe janë shqyrtuar qështjet se çfarë mund të bëjnë këto dy institucione më shumë, që në vend të kritikave të ndërsjellta të gjenden mundësi që të eliminohen të gjitha ato vështërsi në këtë bashkëpunim. Jemi munduar që këtë raport ta përshkruajmë aq sa na lejon ligji, sepse të gjitha ato informata duhet t'i trajtojmë si konfidenciale. Nuk po themi se ka rritje të korrupsionit, korrupsioni është ky që është, mirëpo ne kemi konstatuar se kemi marrë dhe trajtuar më tepër informata dhe kjo si rezultat i zhvillimit si institucion.

Bashkëpunimin në radhë të parë është me prokurinë publike, sepse atje adresohen informatat, zhvillohen hetimet paraprake, mbledhet dokumentacioni. Si agjenci kemi qasje sipas ligjit në të gjitha dokumentet publike dhe nëse arrijmë të gjejmë prova, i dërgojmë rastet në prokurori. Në prokurorinë e EULEX-it i dërgojmë informatat më të ndjeshme, më problematike. Kemi përmendur sekretariatit gjyqësor që ka qenë njëri nga institucionet publike që ka refuzuar që të bashkëpunojë me ne, sidomos me rastin e implementimit të strategjisë antikorrupsion. Nuk kemi pasur rast tjetër që ka refuzuar që të bashkëpunojë me ne. Janë të obliguar edhe në bazë të ligjit edhe në bazë të Kushtetutës, neni 142, që të gjitha institucionet t'i përgjigjen institucionit të pavarur, në këtë rast AKK- së.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për shkak të mungesë së kuorumit nuk mund të nxjerrë përfundime dhe rekomandime për pikat e shqyrtuara të rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi në orën 13 :00

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Haki Shatri